



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 155 Prot

Tiranë, më 14.10. 2009

VENDIM Nr. 13 dt. 13.10.2009

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 13.10.2009, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara nga Këshilli Shkencor pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës:

**VENDOSI:**

Lidhur me projektin e ndërtimit të segmentit të Rrugës Kanali i Çukës – Butrint, u bënë vërejtjet si më poshtë:

1. Gjatë punimeve të rrugës duhet të ketë survejime në gërmimet pranë karakollit, murit antik të Demës si dhe pranë lokalit në hyrje të Butrintit, pasi mendohet se aty ka patur një varrezë antike.
2. Të vihet në dukje stratigrafia e murit antik të Demës.
3. Inertet e rrugës, të mos hidhen në profilin e saj, veçanërisht të evadohen nga zona A.
4. Lartësia e murit mbajtës pranë karakollit, të jetë në kuota sa më minimale.
5. Muri mbajtës i karakollit të jetë mur guri.
6. Pjesa e rrugës nga kthesa e Ksamilit deri në Parkun e Butrintit, të trajtohet me trotuar të ngushtë pedonal.
7. Në segmentin nga Ksamili deri në Parkun Butrinti të shtohet gjelbërimi dhe ndriçimi.
8. Sheshi i parkimit të autobusëve pranë hyrjes së Parkut të Butrintit të shtrohet me pllaka guri.
9. Të ngrihet një parking në hyrje të zonës A të parkut.
10. Ngarkohen ark. Luçiano Bojaxhiu, dhe ark. Gjergj Bakallbashi, të ndihmojnë në hartimin e projektit, për të zbatuar vërejtjet e sipërpërmendura.
11. Të gjitha vërejtjet e sipërpërmendura të vendosen si pjesë shënimesh teknike në projekt.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
FERDINAND XHAFERRI

SEKRETAR I KKR  
PROF. DR. VALTER SHTYLLA

Rruga "Aleksandër Mojsiu", nr. 76, Tiranë (AL), Email: imk@albmail.com